



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Planlama, Şehirleşme, Jeodezi ve Kadastro Müdürlüğü

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi Dhe Kadastër

Dt: 29.06.2026

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes mjedisore në Komunën e Mamushës, dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për mjedisin, Ligji i Mjedisit Nr.03/L025, Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr.03/L-015, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës së Mamushës, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër bënë këtë:

NJOFTIM

Komuna e Mamushës fton dhe njofton trupat konsultative, institucionet relevante dhe publikun e gjerë që të shprehin mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës 2026–2034.

Afati për shprehjen e mendimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve për këtë dokument do të jetë nga data 29.06.2026 deri më 29.07.2026.

Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet mund të dorëzohen përmes email adresës: info@insi-ks.com si dhe esra.butuc@rks-gov.net, ose drejtpërdrejt në Komunën e Mamushës, përkatësisht në zyrën e Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër.

Draft Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës 2026–2034 mund të merret edhe në faqen zyrtare të Komunës së Mamushës: <https://mamushe.rks-gov.net/>





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Planlama, Şehirleşme, Jeodezi ve Kadastro Müdürlüğü

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi Dhe Kadastër

Dt: 29.06.2026

FTESE

Z / Znj. _____

Ftoheni që të merrni pjesë në diskutimin publik për Draft - Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës 2026–2034.

Vendi i takimit:

Salla e Kuvendit të Komunës së Mamushës

Datë:

20.07.2026

Ora:

10:00

Pjesëmarrja juaj do të kontribuojë në ngritjen e kualitetit të ambientit ku jetojmë e punojmë, konform nevojave, kërkesave dhe mundësive tona. Pjesëmarrja juaj rrit dhe ndan ndjenjën e përgjegjësisë mbi vendimet e marra për të siguruar që Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Mamushës 2026–2034 të jetë i suksesshëm, i qëndrueshëm dhe motivues për qytetarët.

Pjesëmarrja juaj në këtë takim është e mirëseardhur.

Ju mirëpresim!

Drejtori:

Glina Morina